



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

## **RAPORT MONITORIMI**

**PËR VEPRIMTARINË E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT  
NË ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME PARLAMENTARE  
QË U ZHVILLUAN NË DATË 25 PRILL 2021**

**MAJ 2021**

## - Hyrje

Avokati i Popullit si një institucion i pavarur, kushtetues, ka si shtylla kryesore të veprimtarisë së tij, mbrojtjen, parandalimin e shkeljeve dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të ligjshme të individit. Në këtë kuadër, ushtrimi efektiv i së drejtës së votës në një proces zgjedhor, ka qënë dhe është në fokus të veprimtarisë sonë, gjatë gjithë proceseve zgjedhore. Ndër vite institucioni i Avokatit të Popullit ka monitoruar proceset zgjedhore të zhvilluara në vend (si zgjedhjet vendore, ashtu edhe ato parlamentare), në përputhje me mandatin e tij. Theksojmë se zgjedhjet e lira dhe të ndershme, janë një nga shtyllat thelbësore të shtetit të së drejtës, ndaj jemi të mendimit se në këto procese, roli i institucionit të Avokatit të Popullit është shumë i rëndësishëm.

Për realizimin e këtij objekti, Avokati i Popullit ka ndërmarrë me iniciativë trajtimin e çështjeve lidhur me: aksesin dhe lehtësitë e krijuara në qendrat e votimit për personat me aftësi të kufizuara, zbatimin e dispozitave të Kodit Zgjedhor që garantojnë barazinë gjinore, respektimin e dispozitave ligjore që garantojnë afishimin dhe shpërndarjen e materialeve propagandistike gjatë fushatës zgjedhore, ushtrimin e së drejtës së votës të personave të moshuar në Shtëpitë e të Moshuarve, ushtrimin e së drejtës së votës nga personat e ndodhur në vendet e privimit të lirisë ditën e votimit, përdorimi i një gjuhe etike komunikimi gjatë fushatës zgjedhore, etj.

Referuar zhvillimit të proceseve zgjedhore dhe raportit që ato krijojnë me liritë dhe të drejtat e ligjshme të qytetarëve, vizioni dhe qëllimi i Avokatit të Popullit, ka qënë dhe mbetet konsolidimi dhe rritja e standardeve të respektimit të të drejtave të njeriut në këtë fushë. Pikërisht, për këtë arsye, raportet e monitorimit të institucionit të Avokatit të Popullit për proceset zgjedhore në vend, janë një mekanizëm i rëndësishëm, jo thjesht për paraqitjen e gjetjeve, por mbi të gjitha për bërjen e rekomandimeve që do shërbejnë për ruajtjen e garancive ligjore që lidhen me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Në lidhje me zgjedhjet e përgjithshme parlamentare, që u mbajtën në datën 25 prill 2021, institucioni i Avokatit të Popullit ka zhvilluar një proces të gjerë monitorimi i cili u përqëndrua në këto faza të procesit zgjedhor:

1. *Përgatitja për procesin zgjedhor*
2. *Dita e zgjedhjeve.*

## 1. Veprimtari të kryera gjatë përgatitjeve për procesin zgjedhor:

### a. Dhënie mendimi dhe sugjerimesh mbi hartimin e legjislacionit zgjedhor

- Pavarësisht se Kodi Zgjedhor, nuk e ngarkon institucionin e Avokatit të Popullit me detyra specifike në procesin zgjedhor, në kuadër të kompetencave të tij të përgjithshme dhe si një institucion i pavarur, i parashikuar shprehimisht në Kushtetutë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, institucioni ynë u ftua të jepte mendime dhe sugjerime, për disa ndryshime për kuadrin ligjor rregullator, mbi bazën e të cilit u zhvilluan zgjedhjet parlamentare, të datës 25 prill 2021.

Kështu, gjatë diskutimeve për amendimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në lidhje me çështjet e zgjedhjeve (miratuar me 30.07.2020) dhe amendimeve të Kodit Zgjedhor (miratuar më 05.10.2020), institucioni ynë u ftua të jepte opinionin e tij gjatë procesit legjislativ, për diskutimin në lidhje me këto ndryshime të propozuara. Qëndrimi i institucionit tonë për ndryshimet e propozuara, kishte të bënte vetëm me çështje që lidheshin me liritë dhe të drejtat themelore të shtetasve që preken apo ndikohen nga proceset zgjedhore. Mendimet dhe sugjerimet tona u morën parasysh pjesërisht gjatë diskutimeve të zhvilluara dhe miratimit të projektligjeve përkatëse.

Duke e konsideruar institucionin e Avokatit të Popullit, si një institucion të një rëndësie të veçantë për raportimin e gjendjes së respektimit të të drejtave të njeriut dhe si një burim informacioni të besueshëm lidhur me këto çështje, reporterët e Komisionit Evropian për Demokraci Përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), zhvilluan një takim « on line », me Avokatin e Popullit dhe përfaqësues të tjerë të institucionit tonë,<sup>1</sup> përpara hartimit të një opinionimi mbi ndryshimet e ndodhura në legjislacionin në fuqi për çështjet zgjedhore. Më pas, Komisioni i Venecias dhe Zyra e OSBE-së për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut (OSCE/ODIHR) përgatitën dhe bënë publik, dokumentin «Opinion i përbashkët mbi ndryshimet në Kushtetutë dhe në Kodin Zgjedhor».<sup>2</sup>

Mendimet dhe vlerësimet e shprehura nga Avokati i Popullit gjatë takimit « on line » me përfaqësuesit e Komisionit të Venecias, rezultuan në të shumtën e tyre në të njëjtën linjë logjike dhe konceptuale vlerësimet dhe komentet e dhëna në opinionin përkatës, të miratuar nga Këshilli për Zgjedhje Demokratike, në takimin e tij të 70-të (online), të zhvilluar në datë 10 dhjetor 2020.

<sup>1</sup> Për shkak të pandemisë së COVID-19, vizita fizike në Tiranë e reportereve të këtij Komisioni nuk ishte e mundur, por në 23, 24 dhe 27 nëntor 2020, si dhe më 1 dhjetor 2020 u zhvilluan video-konferenca me Avokatin e Popullit.

<sup>2</sup> [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2020\)036-alb](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2020)036-alb)

*b. Hartimi i Rekomandimeve për institucionet përgjegjëse për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor*

Në fazën e përgatitjeve për zhvillimin e procesit zgjedhor, puna e institucionit tonë u bazua në një qasje proaktive, për monitorimin e elementëve të cilët garantojnë një proces dhe fushatë zgjedhore, që respekton standardet e gjithëpranuara të zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe demokratike.

Veprimtaria jonë e kryer gjatë kësaj faze të procesit zgjedhor kishte për qëllim sjelljen në vëmendjen e të gjithë aktorëve shtetërorë, të atyre problematikave shqetësuese që institucioni ynë kishte konstatuar nga monitorimi i proceseve zgjedhore paraardhëse, apo edhe të çështjeve aktuale, të konstatuara gjatë këtij procesi zgjedhor.

Problematikat e konstatuara në këtë fazë të procesit zgjedhor janë pasqyruar dhe i janë adresuar institucioneve përgjegjëse shtetërore, nëpërmjet dy rekomandimeve, të dhëna si më poshtë:

**b.1. Rekomandimi datë 6.4.2021 drejtuar: Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve/Komisionit Rregullator** “Rekomandim për përmirësimin e Udhëzimit nr.1 datë 5.12.2020 “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, të miratuara nga Komisioni Rregullator, në KQZ”.

Objekti i këtij rekomandimi ishte:

*« Përmirësimi, në një kohë sa më të shpejtë të mundshme, i Udhëzimit nr.1 datë 5.12.2020 “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, të miratuar nga Komisioni Rregullator, në KQZ.*

*Shtimi i parashikimeve të detajuara në këtë udhëzim, të cilat kanë të bëjnë me krijimin e lehtësive për votimin e personave me aftësi të kufizuara (PAK), në qendrat e votimit, si dhe për çështjet e tjera të parashtruara nga ana jonë në këtë rekomandim ».*

Pavarësisht se ky Rekomandim iu dërgua nga ana jonë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, rreth një muaj e gjysëm para ditës së votimit, përgjigja nga ana e këtij të fundit u dërgua rreth dy javë pas datës së votimit, me anë të shkresës nr.3412/1 datë 7.05.2021. Në këtë përgjigje na është konfirmuar se, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve do të bëjë vlerësimin e përgjithshëm të problemeve të hasura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të zhvilluara në datën 25 Prill

2021, lidhur me infrastrukturën mbështetëse e cila ngrihet tërësisht sipas një mekanizmi, kriteresh, afatesh dhe ndërveprimi institucional të mirëpërcaktuar.

Duke u shprehur se, respektimi i kërkesave dhe kriterëve ligjore për qendrat e votimit dhe detyrimi ligjor për t'u garantuar personave me aftësi të kufizuara, të drejtat politike dhe mundësinë për të votuar, është prioritet i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, në përgjigjen e sipërcituar është garantuar shtimi i parashikimeve të detajuara në aktet nënligjore të këtij institucioni, për krijimin e lehtësive për votimin e personave PAK, në qendrat e votimit.

Në fakt, nga monitorimi ynë në terren për zbatimin e këtij rekomandimi, para ditës së votimit dhe gjatë ditës së votimit rezultoi se, ai u zbatua vetëm pjesërisht.

**b.2. Kërkesë për informacion, datë 2.4.2021, drejtuar gjithë kryetarëve të Bashkive të Shqipërisë,** ku kërkohet informacion, «Për krijimin e kushteve në qendrat e votimit, që do të mundësojnë ushtrimin efektiv të së drejtës së votës nga ana e personave më aftësi të kufizuar»,

me objekt: *Parashikimin e një mekanizmi efektiv për kontrollin e përmbushjes së kriterëve ligjore nga ana e organeve përkatëse të njësive të vetëqeverisjes vendore, të cilët qëllimojnë krijimin e kushteve të përshtatshme në qendrat e votimit, për ushtrimin lirisht të së drejtës së votës nga ana e personave më aftësi të kufizuar.*

Kjo kërkesë për informacion iu dërgua kryetarëve të 61 (gjashtëdhjetë e një) bashkive, në të gjithë vendin. Ndërkohë, informacionin e kërkuar nga ana jonë, e kanë dërguar në afat (para datës së zhvillimit të zgjedhjeve), 32 bashki. Në informacionin e dërguar janë cituar masat e marra nga ana e organeve përgjegjëse të njësive të vetëqeverisjes vendore për mbarëvajtjen e zgjedhjeve, në këtë komponent specifik të tyre si dhe në disa raste, problematikat e ndeshura për përmbushjen e plotë të detyrimeve që rrjedhin nga ligji.

Nga monitorimi në terren i zbatimit të masave të kërkuara nga ligji, për krijimin e kushteve në qendrat e votimit, që mundësonin ushtrimin efektiv të së drejtës së votës nga ana e personave më aftësi të kufizuar, rezultoi se kishte shumë problematika në këtë drejtim.

### *c. Takime, shkresa dhe deklarata informuese e sensibilizuese*

c.1. Në datën 17 Shkurt 2021, Avokati i Popullit, zj. Erinda Ballanca, zhvilloi një **takim** (me kërkesën e saj) **me kreun e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve**, z.Ilirian Celibashi.<sup>3</sup> Çështjet e ngritura nga Avokati i Popullit, në këtë takim ishin:

---

<sup>3</sup> <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/news/this-article-is-available-only-in-albanian-601/>

1. Mospërdorimi i gjuhës së urrejtjes dhe asaj seksiste në zgjedhje.
2. Nevoja e hartimit të një Kodi Etik që do të përcaktonte qartë rregullat që përfaqësuesit politikë nuk duhet t'i shkelin, në fjalët e tyre publike, gjatë fushatës zgjedhore.
3. Garantimi dhe masat e marra për votimin e emigranteve dhe/ose personave me qëndrim të përkohshëm, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
4. Shmangia e përfshirjes së të miturve në fushatë.
5. Sigurimi i përshtatshmërisë së infrastrukturës zgjedhore, si qendrat e votimit apo fletët e votimit, për personat me aftësi të kufizuara.
6. Garantimi i së drejtës së votës për kategori të caktuara individësh, si psh për personat e prekur apo të karantinuar si pasojë e COVID-19.

Nga ana e kreut të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, u premtua se do merreshin masa për çështjet e ngritura nga ana jonë, u vazhdua bashkëpunimi për një çështje që do të trajtohet hollësisht në vijim (hartimi i Kodit të Sjelljes), ndërsa për disa çështje të tjera (votimi i emigrantëve dhe i personave që nuk mund të dilnin nga shtëpitë e tyre për të votuar, për shkak të karantinës), na u tha se kishte nevojë për amendime ligjore.

c.2. Institucioni i Avokatit të Popullit iu drejtua Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me dy kërkesa të përsëritura për dhënien e një informacioni të detajuar, lidhur me masat e marra, apo që do të ndërmerreshin, për krijimin e lehtësirave për votimin e personave me aftësi të kufizuara.<sup>4</sup>

Në përgjigjen e dhënë nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, me shkresën nr.4153/1 datë 18.05.2021, veç sqarimeve që lidhen me parashikimet ligjore në caktimin e qendrave të votimit na u konfirmua se, të gjitha qendrat e votimit janë vendosur në katet e para të godinave për të lehtësuar pikërisht aksesin e tyre edhe nga personat me aftësi të kufizuar. Po kështu, në përgjigje thuhet se, në ato qendra votimi ku referuar listës së zgjedhësve ka zgjedhës të tillë dhe ku infrastruktura e godinës e ka lejuar, janë vendosur edhe rampa për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Në vazhdim të përgjigjes jemi informuar se, në rastet kur kryetarët e qeverisjes vendore, kanë njoftuar për numrin e zgjedhësve të verbër dhe qendrat e tyre të votimit, qendrat e votimit përkatëse janë pajisur me shabllonin e alfabetit braille. Si përmbushje e detyrimeve ligjore në këtë drejtim, përmenden edhe pajisja e çdo qendre votimi me dhomën e fshehtë në dimensione të tilla që mundëson lehtësisht votimin edhe nga personat me aftësi të kufizuara si dhe përfshirjen e interpretimit të gjuhës së shenjave në të gjitha spotet e fushatës elektorale dhe sensibilizuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

<sup>4</sup> Shkresa nr.K1/S4-12prot., datë 14.04.2021 dhe shkresa Nr.K1/S4-26 prot, datë 21.04.2021.



Nga monitorimi në terren i zbatimit të masave të premtuara që do të merreshin, rezultoi se kishte shumë problematika. Më konkretisht, nga ana e grupeve tona të monitorimit në ditën e zgjedhjeve, rezultoi që veç të tjerash kishte qendra votimi që ishin në katet e dyta të godinave.

### FOTO ILUSTRUESE

c.3. Në datë 6 prill 2021, Avokati i Popullit, zj. Erinda Ballanca, zhvilloi një takim me shefen e Misionit Vëzhgues të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare në Shqipëri, Ambasadoren zj. Urszula Gacek dhe stafin e saj, pas kërkesës së këtyre të fundit, me objekt diskutimi zgjedhjet parlamentare të datës 25 prill 2021. Në këtë takim u diskutua mbi kompetencat e institucionit tonë në proceset zgjedhore, veprimet e ndërmarra nga ana e Avokatit të Popullit deri në atë periudhë, si edhe ato që parashikoheshin të kryheshin në ditën e zgjedhjeve.

## 2. Monitorimi i qendrave të votimit për aksesin e Personave me Aftësi të Kufizuar, përpara ditës së zgjedhjeve

Avokati i Popullit përveç të tjerave, është një institucion monitorues për zbatimin e ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” (neni 16), në zbatim edhe të Konventës së OKB-së, “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”.

Në përputhje me nenin 108 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohen procedurat e votimit për zgjedhësit që nuk mund të votojnë vetë, duke filluar që nga regjistrimi në listat e zgjedhësve të qendrës përkatëse të votimit, infrastruktura e përshtatshme për lehtësimin e pjesëmarrjes në votime për personat paraplegjikë e tetraplegjikë, si dhe pajisja e komisioneve të qendrave të votimit me mjete të posaçme votimi për personat që nuk shikojnë; praktika e konsoliduar e veprimtarisë së Institucionit të Avokatit të Popullit në këtë fushë të të drejtave të njeriut ka qenë kryerja e monitorimeve për respektimin e parashikimeve ligjore të sipërcituara nga ana e institucioneve shtetërore përgjegjëse. , Monitorimet e kryera kanë patur si qëllim kryesor të tyre, evidentimin e problematikave potenciale ekzistuese dhe marrjen e masave të nevojshme, përkatëse për garantimin e së drejtës së votës për personat që përfshihen në kategorinë e personave me aftësi të kufizuar.

Për sa më sipër, një grup inspektimi i institucionit tonë, i drejtuar nga Komisioneri i Seksionit të Përgjithshëm dhe i përbërë nga ndihmëskomisionerët

e këtij seksioni, si dhe nga përfaqësues të Zyrave Rajonale të Avokatit të Popullit, bazuar në një plan pune, kryen monitorimin e aksesueshmërisë në infrastrukturë të personave me aftësi të kufizuar, në qendrat e votimit në disa qytete të Shqipërisë, dhe përkatësisht në: Tiranë, Korçë, Maliq, Ersekë, Përmet, Këlcyrë, Tepelenë, Lezhë, Shëngjin, Lushnjë, Divjakë, Elbasan, Belsh, Durrës, Kavajë, Shkodër, Kukës, Berat, Pogradec, Vlorë, Sarandë, Dropull.

Objektivat e këtij inspektimit ishin evidentimi në terren i përmbushjes së kërkesave ligjore për lehtësimin e aksesit të personave me aftësi të kufizuar në qendrat e votimit, sa i takon: a) Vendosjes së rampave për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë; b) Përshtatshmërisë së infrastrukturës (sinjalistika me shirita të verdhë) për hyrjen në qendrat e votimit të personave me aftësi të kufizuar në shikim dhe personave të verbër, si dhe për të garantuar votimin e pavarur dhe të fshehtë me fletë votimit me shkrimin Brail, për kategorinë e votuesve, persona të verbër.

Në përfundim të këtij procesi monitorimi, grupi i punës me përkatësi nga Seksioni i Përgjithshëm inspektoi 280 qendra votimi, ndërkohë që përfaqësuesit e Zyrave Rajonale inspektuan 582 qendra votimi.

Nga konstatimet e kryera u vunë re mjaft mangësi në një sërë godinash të përcaktuara si qendra e votimi, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021. Këto mangësi u konstatuan për sa i takon mungesës së përshtatshmërisë së infrastrukturës për personat me aftësi të kufizuar në shikim në ambientet e përcaktuara si qendra votimi, dhe nga ana tjetër në një pjesë të madhe të tyre, sa i takon mungesës së rampave të nevojshme për lehtësimin e aksesit, kryesisht kjo në godinat ku ndodheshin ambientet e përcaktuara si qendra votimi, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Në përgjithësi në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme të qyteteve ku u kryen monitorimet përkatëse, kishin rampë të vendosur në ambientet e jashtme që mundësonte aksesueshmëri për katet e para të godinave, kurse në shkollat e fshatrave dhe qendrat e tjera nuk kishte fare rampë.

Gjithashtu, në rastet kur qendrat e votimit ishin parashikuar të vendoseshin në ambiente në katin e dytë të godinave përkatëse, u konstatua se për aksesueshmërinë e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, nuk ishin parashikuar masa specifike.

Shiritat e verdhë për aksesueshmërinë e personave që nuk shikojnë, mungonin totalisht në të gjitha qendrat e votimit të inspektuara.

Një konstatim i rëndësishëm, lidhur me shkresën tonë drejtuar kryetarëve të Bashkive, ishte se për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të 25 prillit 2021, *nuk u parashikua asnjë fond investimesh nga këto Bashki, që do siguronte aksesueshmërinë në infrastrukturë të personave me aftësi të kufizuar,*



### 3. Deklaratë për mediat në lidhje me ndalimin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes në takimet elektorale

Në datën 12 mars 2021, me anë të një deklaratë për shtyp,<sup>5</sup> Avokati i Popullit dënoi gjuhën e urrejtjes të përdorur nga forca politike që përbënte mazhorancën aktuale në Kuvendin e Shqipërisë, gjatë prezantimit të kandidatëve të saj për garën elektorale.

Avokati i Popullit theksoi se: Manipulimi, përshtatja dhe përdorimi i veçantive gjinore, karakteriale apo fizike të cilitdo qytetar, me qëllim vendosjen e tij në pozita poshtëruese, nuk është një sjellje në përputhje me standardet e përcaktuara në aktet ndërkombëtare dhe interpretimin e bërë prej tyre, veçanërisht nga rekomandimi nr. 15, i Komitetit kundër Racizmit dhe Intolerancës të Këshillit të Evropës (ECRI).

Kjo lloj retorike mund të ndikojë në shndërrimin e urrejtjes dhe dhunës që buron prej urrejtjes, në model sjelljeje për shoqërinë tonë.

Gjuha e papërshtatshme është një formë e gjuhës së urrejtjes dhe përdorimi i saj në debatin politik dhe elektorale, për cilindo që nuk ndan të njëjtat pikëpamje me përfaqësuesit politikë, kthehet në shembull për mijëra ndjekës, të cilët e transferojnë dhe riprodhojnë gjuhën e papërshtatshme, urrejtjen dhe dhunën, në mjedisin ku jetojnë, në shoqëri e familje.

Duke vlerësuar të ligjshëm shqetësimin për këtë ngjarje nga ana e shumë organizatave joqeveritare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, veçanërisht të organizatave në mbrojtje të të drejtave të gruas dhe kundër diskriminimit, Avokati i Popullit dënoi gjuhën e urrejtjes në prezantimin elektorale të mësipërm dhe ju bëri thirrje të gjitha partive politike, për ndalim të menjëhershëm të kësaj qasjeje. Avokati i Popullit bëri thirrje për ndarjen nga praktikat sipërfaqësore të marrëdhënieve publike, ku skandalizimi përdoret si mjet për devijim debati, me koston e dhunimit të dinjitetit të çdo qytetari të vendit tonë, dhe shkatërrimin e standardeve të arritura me mund, në respektimin e të drejtave të njeriut.

### 4. Hartimi i Kodi të Sjelljes të sjelljes së partive politike shqiptare, gjatë fushatave zgjedhore

Nisur nga eksperiencia të mëparshme, në kuadër të një projekti të Zyrës së Këshillit të Europës në Tiranë,<sup>6</sup> institucioni ynë si pjesë e Aleancës Kundër

<sup>5</sup> <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/news/this-article-is-available-only-in-albanian-609/>

<sup>6</sup> Projekti “Anti-Discrimination Promotion of Diversity and Equality in Albania EU/CoE Horizontal Facility for the Western Balkans and Turkey II” <https://www.coe.int/en/web/inclusion-and-antidiscrimination/horizontal-facility-ii>

Urrejtjes,<sup>7</sup> inicioi procesin e hartimit dhe konsultimit të Kodit të Sjelljes së partive politike shqiptare, gjatë fushatave zgjedhore.<sup>8</sup>

Në bashkëpunim me Komisionerin Shtetëror për Zgjedhjet, në një aktivitet të zhvilluar nga Aleanda Kundër Urrejtjes, ky Kod Sjelljeje u konsultua me partitë politike të përfaqësuara në Kuvendin e Shqipërisë, si dhe të tërë subjektet garues që morën pjesë në zgjedhjet e 25 prillit 2021.

Në përfundim të konsultimeve, ky Kod u miratua (nënshkrua) nga partitë kryesore politike në versionin e propozuar nga Aleanca Kundër Urrejtjes, dhe vlen të theksohet se, ky Kod do të jetë i vlefshëm edhe për zgjedhjet e ardhshme vendore, apo parlamentare.

Shtojmë se po në kuadër të këtij projekti, nga Aleanca Kundër Urrejtjes, janë përgatitur edhe raportet e monitorimit ku është identifikuar e vlerësuar gjuha e përdorur në media gjatë fushatës zgjedhore. Këto raporte monitorimi do të bëhen publike nga Aleanca Kundër Urrejtjes.<sup>9</sup>

5. Rekomandimi për marrjen e masave për ushtrimin e të drejtës së votës, për shtetasit shqiptarë të ndodhur jashtë vendit dhe që ktheheshin në Shqipëri ditën e votimeve

Në datë 19.4.2021, Komiteti Teknik i Ekspertëve pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, propozoi si një masë parandaluese për përhapjen e Covid-19, që të gjithë shtetasit shqiptarëvinin në Shqipëri, nga Maqedonia e Veriut dhe Greqia, të karantinoheshin për një periudhë dy javore. Ky propozim mori karakter detyrues pas nxjerrjes dhe hyrjes në fuqi të Urdhërit nr.219 datë 19.04.2021 “Për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia, nga ana e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Avokati i Popullit duke vlerësuar se një masë e tillë, përbënte pengesë dhe realisht pamundësonte pjesëmarrjen e shtetasve shqiptarë, të cilët mund të vinin nga Greqia ose Maqedonia e Veriut, për të ushtruar efektivisht të drejtën e tyre themelore për të votuar, nëpërmjet një rekomandimi drejtuar Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me shkresën tonë nr. 1413/2 prot., datë 22.4.2021, u kërkua anulimi tërësisht e menjëherë i Urdhërit nr.219 datë

<sup>7</sup> Përveç institucionit tonë në këtë Aleancë marrin pjesë edhe institucionet shtetërore të: Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Autoriteti i Mediave Audio-vizive, si dhe Organizata Jofitimprurëse “Këshilli Shqiptar i Medias”

<sup>8</sup> Kodi përmban rregulla etike për mënyrën e sjelljes së partive politike gjatë fushatave zgjedhore dhe tekstin e plotë të tij, mund ta gjeni në .... [Linku](#), si dhe në Aneksin bashkëngjitur.

<sup>9</sup> Raportet e këtyre monitorimeve mund të gjenden në linkun [...](#)

19.04.2021 “Për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia.”<sup>10</sup>

Pavarësisht se në nenin 21, pika b, të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: “*Paraqitja e rekomandimit pezullon aktet ose veprimet e paligjshme apo të parregullta deri në shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe dhënien e përgjigjes Avokatit të Popullit*”, ky Rekomandim i yni, jo vetëm nuk solli anulimin e Urdhërit të sipërcituar të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, por siç na rezultoi nga mediat, ai filloi të zbatohet nga Policia e Shtetit, ende pa hyrë në fuqi.<sup>11</sup>

Shtojmë se deri në momentin e hartimit të këtij Raporti, institucioni ynë nuk ka patur asnjë përgjigje për këtë Rekomandim.

Për rëndësinë e kësaj çështjeje, pati edhe një interesim të madh nga mediat, për të cilat Avokati i Popullit dha një sërë intervistash të pasqyruara ekskluzivisht nga televizionet kryesore të vendit.<sup>12</sup>

Në vijim të Rekomandimit tonë edhe Presidenti i Republikës, me shkresën nr. 1413/2 prot., datë 22.4.2021, drejtuar një sërë institucionesh publike, prezencës ndërkombëtare në vend, partive politike me përfaqësim në Kuvendin e Shqipërisë dhe deputetëve të pavarur në Kuvendit,<sup>13</sup> kërkoi gjithashtu, përmbushjen e rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit për anulimin e urdhërit nr. 219, datë 19.4.2021, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për heqjen e çdo pengese ndaj shtetasve shqiptarë që kthehen në atdhe nga Republika e Greqisë dhe Republika e Maqedonisë së Veriut për të votuar në 25 prill 2021. Në përgjigje të këtij rekomandimi, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dërgoi shkresën nr.1938/1 datë 12.05.2021, në të cilën bëhej një analizë mbi kompetencat e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të nxjerrë urdhëra, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, i ndryshuar, dhe informoheshim se Urdhëri nr.219 datë 19.04.2021 i Ministrit të Shëndetësisë dhe

<sup>10</sup> Teksti i plotë i Rekomandimit ndodhet i botuar në ... [linku](#), si dhe në Aneksin bashkëngjitur këtij Raporti.

<sup>11</sup> <https://www.asp.gov.al/kakavije-gjirokaster-drejtori-i-departamentit-te-kufirit-dhe-migracionit-eduart-merkaj-inspektim-ne-piken-e-kalimit-kufitar-per-masat-ne-prag-te-zgjedhjeve/>

<sup>12</sup> [Linqet perkatese](#)

<sup>13</sup> Shkresa nr. 1413/2 prot., datë 22.4.2021 e Presidentit të Republikës, iu drejtua Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komitetit Teknik të Ekspertëve, organeve drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Drejtorisë së përgjithshme të Policisë së Shtetit. Kjo shkresë u përcoll në vëmendje të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë; misionit të OSBE/ODIHR për vëzhgimin e zgjedhjeve, zyrës së OSBE-së në Shqipëri, Delegacionit të Bashkimit Europian në Shqipëri, Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Ambasadës Britanike, Zyrës së Këshillit të Europës në Tiranë, si dhe ju dërgua për dijeni, Partisë Socialdemokrate, Partisë Balli Kombëtar, Partisë Lëvizja Demokratike Shqiptare, Partisë Bindja Demokratike, Partisë Aleanca Bashkimi Popullor, Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, Partisë Nisma Thurje, Partisë Lëvizja e re, Partisë Demokratike, Partisë Aleanca Demokracia e Re, Partisë Lëvizja për ndryshim, Partisë Socialiste dhe kandidatit të pavarur Boiken Abazi.

Mbrojtjes Sociale, ishte bazuar në vendimin e Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Koronavirusi i ri, nr.1892 datë 19.04.2021.

I vetmi shpjegim konkret, lidhur me sa parashtrohej në rekomandimin tonë, gjendej në paragrafin e fundit të shkresës së sipërcituar, ku thuhej se: *“Për sa më sipër, ritheksojmë edhe njëherë faktin se vendimi i Komitetit i cili është finalizuar me Urdhërin e Ministrit të Shëndetësisë nr.219 datë 19.04.2021 “Për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia”, është marrë bazuar në të dhënat e fundit epidemiologjike të vendit tonë dhe të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Greqisë, si dhe në shtimin e rasteve të reja me Covid, gjatë periudhës së festave të Krishtlindjeve dhe të fundvitit, si dhe të Festës së Pashkëve në vitin e kaluar dhe ka si qëllim të vetëm parandalimin e infeksionit të shkaktuar nga Covid-19”.*

Në gjykimin dhe vlerësimin e Avokatit të Popullit, kjo përgjigje nuk analizon aspak thelbin e rekomandimit dërguar Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për këtë çështje. Përgjigja formale e kthyer nga ana e këtij institucioni, faktikisht është brenda afatit procedural të vendosur nga ligji nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, por nuk i përgjigjet urgjencës së çështjes së ngritur në rekomandim dhe qëndrimin të shpejtë, të kërkuar nga ana e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për këtë rekomandim tonin.

Vlen të theksohet fakti se, përgjigja e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, na u dërgua pasi, Urdhëri i Ministrit të Shëndetësisë nr.219 datë 19.04.2021 “Për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia”, kishte humbur fuqinë e tij juridike dhe nuk sillte më pasoja.

Sikurse na rezulton, subjekti politik, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim ka paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, një kërkesë për marrjen e masës së përkohshme të sigurimit të padisë, duke pezulluar Urdhërin nr.219 datë 19.04.2021, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me motivin se kjo masë e propozuar dhe e vendosur në urdhërin e sipërcituar, sillte pengimin e së drejtës kushtetuese për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur.

Me vendimin e datës 23.04.2021, pasi Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, ka shqyrtuar kërkesën ka vendosur shpalljen e moskompetencës funksionale për gjykimin e kësaj çështjeje dhe dërgimin e akteve Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, si gjykatë kompetente.

Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë, në vendimin e saj nr.30 (86-2021-296) Vendimi, datë 24.04.2021, pasi ka shqyrtuar kërkesën e paraqitur nga ana e subjektit Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, ka arritur në konkluzionin se, shqyrtimi i saj nuk bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, por në juridiksionin kushtetues. Pra, se subjekti kërkues nuk duhej ti ishte drejtuar gjykatave administrative, por Gjykatës Kushtetuese. Në këto kushte, Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë ka vendosur mospranimin e kërkesës.

Nisur nga trajtimi që gjykatat administrative i kanë bërë kësaj çështjeje, del e qartë një qasje joefektive e tyre ndaj kërkesës së paraqitur nga ana e subjektit, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, qasje e cila në fakt ka marrë kohë nga koha e vlefshme për mënjanimin e pasojave që cënonin të drejtën e votës, për shkak të zbatimit të Urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.219 datë 19.04.2021 “Për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia”.

#### 6. Deklaratë për mediat në lidhje më përdorimin e të dhënave personale pa dijeninë e tyre, të një numri të madh qytetarësh

Në mesin e muajit prill 2021, nga media u bë publik informacioni se nga Partia Socialiste e Shqipërisë përdorej një bazë të dhënash, e cila përmbante të dhëna personale të qytetarëve. Duke vlerësuar këtë përdorim të dhënash personale, në kundërshtim me legjislacionin specifik të fushës , institucioni i Avokatit të Popullit doli me një një deklaratë publike për mediat,<sup>14</sup> si edhe dha një sërë intervistash në stacione të ndryshme televizive të vendit, ku theksoi qëndrimin se marrja dhe përdorimi i të dhënave personale të qytetarëve, nga cilado parti politike, është e paligjshme, me përjashtim të rastit, nëse vetë qytetarët kanë dhënë një autorizim të posaçëm me shkrim për përdorimin e tyre për qëllimin e lejuar, apo për raste të tjera të veçanta të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Ky qëndrim parimor i Avokatit të Popullit gjen mbështetje në konsiderimin se, mbrojtja e të dhënave personale është një e drejtë themelore e njeriut dhe se, mbledhja e të dhënave personale të shtetasve pa pëlqimin e tyre, lidhet drejtpërdrejtë me jetën e tyre private.

Kjo e drejtë themelore është e sanksionuar në nenin 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet qartë se, askush nuk mund të detyrohet, përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij. Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit, bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj,

<sup>14</sup> <https://ëëë.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/neës/peoples-advocate-position-ëith-regard-to-the-large-number-of-personal-data-of-albanian-citizens-compromised-for-political-purposes-622/>



përfshirje të cilat nuk lidhen në asnjë rast me sa ishte bërë publike përmes medias, por edhe pranuar si e tillë në qëndrime publike nga përfaqësues të ndryshëm, politikë, të Partisë Socialiste.

E drejta për mbrojtje të të dhënave personale bën pjesë tek të drejtat e mbrojtura nga neni 8, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), i cili garanton të drejtën për respektim të jetës private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës dhe përcakton kushtet sipas të cilëve lejohen kufizimet e kësaj të drejte. Ky qëndrim bazohet edhe në jurisprudencën e pasur të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për mbrojtjen e të dhënave personale.

Konventa nr.108, e Këshillit të Europës, si një akt normativ detyruar në nivel ndërkombëtar trajton në mënyrë të posaçme mbrojtjen e të dhënave të individëve. Sipas përcaktimeve të saj, asnjë autoritet publik nuk mund dhe nuk duhet të ndërhyjë ndaj ushtrimit të kësaj të drejte, përveç rasteve të parashikuara shprehimisht nga ligji, si për shembull në interes të sigurimit kombëtar, sigurisë publike, ose mirëqënies ekonomike të vendit, për parandalimin e çrregullimeve të rendit ose parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të të tjerëve.

Ky fakt u bë edhe më shqetësues kur si argument për të mohuar marrjen apo “rrjedhjen” e këtyre të dhënave nga institucione shtetërore, përfaqësues të kësaj force politike deklaruan se këto të dhëna ishin mbledhur e përditësuar ndër vite, por pa u shqetësuar për faktin se ligji e ndalon një gjë të tillë.

Po kështu në këtë bazë të dhënash, kishte edhe një rubrikë të posaçme, ku shënoheshin bindjet politike të individëve, apo të dhëna të tjera private të tyre. Edhe kjo rubrikë në vlerësimin e Avokatit të Popullit, nuk ishte në harmoni me legjislacionin në fuqi, pasi: mendimet dhe bindjet politike, hyjnë tek të dhënat sensitive dhe thellësisht konfidenciale, ku përfshihet çdo informacion për individin, që ka të bëjë me origjinën e tij racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin fetar apo filozofik, dënimin penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale.

Në deklaratën për mediat qartësohej opinioni publik se, institucioni i Avokatit të Popullit ka një mandat të kufizuar në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, pasi me miratimin e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, mbikqyrja dhe monitorimi i mbrojtjes së të dhënave personale, i ka kaluar Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, një institucion i posaçëm, i pavarur ky, i krijuar me ligj. Por Avokati i Popullit në kuadër të mandatit të tij promovues të drejtave themelore të njeriut, vepron për të garantuar këtë të drejtë dhe në çdo rast do të kërkojë nga çdo institucion shtetëror, respektimin dhe mbrojtjen e kësaj të drejte në standardin më të lartë të saj.

Në këtë Deklaratë publike për mediat, Avokati i Popullit i kërkoi autoriteteve shtetërore dhe ligjzbatuese, të merrnin çdo masë të nevojshme, për të ndaluar çdo përdorim të paligjshëm të të dhënave personale dhe çdo forcë politike, të



distancohej në mënyrë të qartë nga të tilla praktika që çenojnë të drejtat e njeriut. Po kështu, u soll në vëmendje të organeve ligjzbatuese dhe u kërkua që çdokush që kishte mbledhur, përpunuar apo ruajtur të dhëna personale, të ishte përgjegjës për të shpërblyer dëmin që u vjen subjekteve të këtyre të dhënave personale, në përputhje me përcaktimin e dhënë në nenin 17, të ligjit “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

*7. Deklaratë për mediat në lidhje më një ngjarje me pasojë humbje jete, nga një konflikt ndërmjet mbështetësve të dy partive politike*

Në datën 21 prill 2021, në qytetin e Elbasanit, ndodhi një ngjarje e rëndë me pasojë humbje jete, nga përplasja e personave të cilët supozohej se ishin simpatizantë të forcave të ndryshme politike. Avokati i Popullit nëpërmjet një deklarate për mediat, dënoi këtë ngjarje dhe bëri thirrje për një fushatë të qetë, të matur e të fokusuar te respekti dhe kujdesi për jetën e dinjitetin e çdo qytetari. Avokati i Popullit, gjithashtu, u bëri thirrje gjithë palëve, subjekteve garuese në zgjedhjet parlamentare të 25 prillit 2021 dhe mbështetësve të tyre, që të distancoheshin e dënonin fuqimisht çdo akt që çonte në deformimin e votës, si dhe të çdo akti dhune.

Në kuadër të verifikimit të pretendimeve dhe shqetësimeve të ndryshme publike, të cilat lidheshin me procesin zgjedhor dhe ushtrimin e së drejtës së votës, institucioni i Avokatit të Popullit ngriti një grup pune dhe verifikoi në Institucionin e Ekzekutimeve të Vendime Penale (IEVP), Reç, Malësia e Madhe Shkodër, deklaratën e bërë publike nga një subjekt politik, i cili pretendonte se kandidati për deputet i subjektit politik kundërshtar po kërkonte blerjen e votave të 350 të burgosurve, në këtë institucion<sup>15</sup>.

Pas kontakteve me Drejtues të IEVP, Reç, si edhe administrimit të dokumentacionit respektiv, rezultoi se në këtë IEVP, vuanin dënimin 421 shtetas, nga të cilët 115 të paraburgosur dhe 346 të dënuar. Në datë 25 prill 2021, kishin të drejtë vote vetëm 168 shtetas, nga të cilët 58 të dënuar dhe 110 të paraburgosur, ndërkohë që pjesa tjetër për shkak të veprës penale të kryer, kishin kufizime ligjore për ushtrimin e të drejtës së votës. Nga ana jonë u administruan lista e të burgosurve me të drejtë vote si dhe lista në total e të dënuarave, t cilët vuanin dënimin në këtë institucion.

Sipas informacionit të parashtruar, deklarata e bërë publike nga subjekti politik është bazuar në faktin se, kontrata e njësisë tregtar<sup>16</sup> që ndodhet brenda ambienteve të

<sup>15</sup> <https://dosja.al/bushati-dennoncon-ps-ne-shkoder-kerkojne-te-blejne-votat-e-350-te-burgosurve-ne-rec/>

<sup>16</sup> Nga ana jonë u administrua kopje e kontratës së njësisë tregtar, lidhur mes subjektit tregtar dhe IEVP Rec pa afat, ndryshe nga sa na u komunikua nga Drejtues të IEVP Reç se kontratat me njësitë e shërbimit lidheshin nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

kësaj IEVP-je, është lidhur me një të afërm të deputetit të zonës, përfaqësues të Partisë Socialiste, prandaj pretendohet se duke qenë se kishte lidhje farefisnore me subjektin kundërshtar politik, mund të kishte blerje të votave të votuesve me të drejtë vote, që kryenin dënimin penal në IEVP, Reç.

Pasi morëm informacionin e nevojshëm, u verifikuan dhe administruan fotokopjeve të regjistrit të ankesave të të burgosurve, organika e institucionit, lista e të dënuarve me të drejtë vote, si dhe u krye administrimi i disa kërkesave të bëra nga të burgosurit, në datat 21, 22 dhe 23.04.2021. Këto kërkesa konsistojnë në pjesën më të madhe, për aplikim të kartave të bankave dhe takime urgjente me Drejtorin. Ndërkohë, mund të veçonim disa kërkesa të dyshimta për blerje TV tek dyqani, të cilat mund të përbëjnë elementë të favorizimit të ndonjë individi brenda regjimit të brendshëm.

Gjithashtu, grupi inspektues kontaktoi përfaqësuesin e subjektit politik që kishte bërë deklaratën, i cili nuk bashkëpunoi dhe nuk na përcolli informacione shtesë, në vijim të denoncimit publik të parashtruar nga ana e tij.

## **2. Veprimtari të kryera ditën e zgjedhjeve**

Për sa i përket ditës së votimit (datë 25 prill 2021), i gjithë stafi i institucionit të Avokatit të Popullit, së bashku me stafin e Zyrave Rajonale (në qytetet Shkodër, Vlorë, Berat, Sarandë, Dropull, Kukës dhe Pogradec), ishte në gadishmëri, dhe në dispozicion të qytetarëve, gjatë gjithë orarit zyrtar të votimeve. Institucioni i Avokatit të Popullit ka qënë i hapur për qytetarët gjatë gjithë ditës gjë që ju bë e ditur publikut edhe nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të institucionit.

Njëkohësisht ishte parashikuar që i gjithë stafi të bënte monitorime në mënyrë të drejtpërdrejtë në terren, në qendra të ndryshme votimi në të gjithë Shqipërinë, për të verifikuar disa elementë të respektimit të ushtrimit efektiv të së drejtës së votës në këtë proces zgjedhor. Këto monitorime lidheshin me përmbushjen e parashikimeve të Kodit Zgjedhor në lidhje me infrastrukturën e qendrave të votimit, për përshtatshmërinë e tyre me akses të lehtësuar për personat me aftësi të kufizuara, apo për personat e verbër; zbatimin në praktikë të nenit 108 të këtij Kodi; etj.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të egër, Çnjerëzor ose Poshtëruar, si pjesë e strukturës së institucionit të Avokatit të Popullit, monitoroi procesin e votimit, në datën 25 Prill 2021, në disa institucione të ekzekutimit të vendimeve penale.

Në përputhje me nenin 19/1, i ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, sipas të cilit:

*“Avokati i Popullit ose personat e autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë pa kufizim e pa autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në burgje, në vende ku policia ose prokuroria mbajnë personat të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar (të paraburgosurit), në reparte ose në institucione shtetërore, në spitale psikiatrike, në azile në shtëpi fëmije, si dhe në çdo vend tjetër kur ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut.*

*Hyrja në të gjitha mjediset e mësipërme mund të bëhet si për të hetuar një ankesë, një kërkesë ose njoftim të caktuar, ashtu edhe me nismën e Avokatit të Popullit për qëllime inspektimi apo studime. Avokati i Popullit në këto raste mund të marrë takim, të bisedojë në mënyrë konfidenciale e pa praninë e personave zyrtarë me cilindo person që ndodhet ose mbahet në këto mjedise...”*, institucioni ynë vuri në dijeni zyrtarisht, Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve,<sup>17</sup> për kryerjen e një veprimtarie sa më normale në monitorimin e qendrave të votimit, që do të vizitoheshin nga stafi ynë, pikërisht ditën e votimit.

Ditën e votimit, institucioni ynë kreu monitorime si në *Qendra të ndryshme votimi në të gjithë Shqipërinë*, ashtu edhe në *Institucionet e Edukimit të Veprave Penale (IEVP)*.

## **2.1 Monitorimet në Qendrat e Votimit, në ditën e votimit**

### *- Metodologjia e monitorimit*

Monitorimi i kryer u bazua në një metodologji monitorimi dhe raportimi, e cila bazohej në përcaktimin e disa kriterëve ligjore specifike që duhej të verifikoheshin në vend dhe konkretisht nga grupet monitoruese, duke konstatuar fizikisht dhe drejtpërdrejtë përmbushjen e tyre, si dhe duke adresuar tërësinë e konstatimeve të kryera në plotësimin e një formulari tip, të miratuar për këtë qëllim. Informacioni i mbledhur nga grupet monitoruese, i raportuar pranë Avokatit të Popullit, së bashku me informacionet e marra zyrtarisht nga ana e organeve shtetërore përgjegjëse për mbarëvajtjen e zgjedhjeve, ka përbërë një nga elementët kryesorë në përgatitjen e këtij raporti.

Në ditën e votimit u monitoruan nga stafi ynë në mënyrë të drejtpërdrejtë, 840 qendra të ndryshme votimi në të gjithë Shqipërinë, ku siç përmendëm më sipër, objekti i këtij monitorimi ishte përshtatshmëria e qendrave të votimit dhe aksesit i lehtësuar në to, për Personat me Aftësi të Kufizuara, dhe ushtrimi i lirë i së drejtës së votës

Përveç verifikimit të infrastrukturës në godinat ku ndodheshin qendrat e votimit, si dhe pajisjen e këtyre qendrave me pajisje të posaçme për të mundësuar dhe lehtësuar

<sup>17</sup> Me shkresën nr. 223 prot., datë 22.04.2021, bashkëngjitur në Aneksin e këtij Raporti.

votimin e personave të verbër, u monitorua edhe respektimi i protokolleve të vendosura, për shkak të Covid-19.

Nga monitorimet e kryera u konstatua sa vijon:

- Në përgjithësi qendrat e votimit të vendosura në katet e para të godinave kishin aksesueshmëri për personat Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, pasi kishin rampë në hyrje të godinave.
- Qendrat e votimit të vendosura në katet e dyta të godinave ishin të paaksesueshme për personat me aftësi të kufizuara (PAK).
- *Në asnjë qendër votimi të monitoruar nuk kishte aksesueshmëri për personat PAK (të verbër), pasi nuk kishte shirita të verdhë, orientues.*
- Në qendrat e votimit kishte mjete të posaçme për votimin e personave me problem në shikim (fleta votimi me gjuhën Braille).
- Përgjithësisht kishte persona jashtë qendrave që ndihmonin personat PAK apo të moshuarit për të vajtur brenda qendrës së votimit.
- Në hyrje të qendrave të votimit, si edhe pranë tyre në korridore, ishin vendosur postera informues për procesin e votimit, si dhe listat e kandidatëve të partive me numrin rendor përkatës.
- *Nuk u konstatua vendosja e posterave me informacion shpjegues për procesin zgjedhor, në gjuhët minoritare.*
- Nuk u konstatua përdorimi i shenjave apo simboleve të ndonjë subjekti partiak zgjedhor, në qendrat e votimit.
- Në qendrat e votimit të Njësisë 10, ku votohej në mënyrë elektronike, nuk kishte masa të veçanta për personat që nuk shikojnë, që t’iu mundësohej votimi. Kishte vështirësi të theksuara të votimit elektronik nga ana e personave në moshë të thyer, të cilët e kishin të domosdoshme ndihmën e një personi tjetër (kryesisht personit që qëndronte pranë pajisjes elektronike) për orientim, për procedurën që duhej të ndiqte. Rrjedhimisht vota e humbiste fshehtësinë e saj.

### ***Disa problematika të konstatuara në qendrat e votimit***

1. Në asnjë qendër votimi nuk ishin marrë masa lehtësuese, për personat me aftësi të kufizuar në shikim.  
Të gjitha infrastrukturat që vizituam dhe që lidheshim me PKA, kishin investimet që ishin bërë më parë në këto objekte (pra rampa që ishin bërë në shkolla) dhe nuk na rezultoi në asnjë rast, që për ditën e votimit të ishte bërë ndonje investim ekstra, i ri, për përshtatshmërinë në lidhje me aftësinë e kufizuar.

2. Brenda qendrave të votimit që ne monitoruam, në asnjë prej tyre nuk kishte listë të afishuar, të kandidatëve të partive politike. Këto lista ishin afishuar në ambientet e jashtme, të godinave ku ishin vendosur qendrat e votimit.

Sipas gërmës c, pika 1, të nenit 101, të Kodit Zgjedhor

*c) afishon udhëzimet për kryerjen e votimit në një vend të përshtatshëm dhe të dukshëm **brenda** qendrës së votimit;"*,

pra në vlerësimin tonë, do duhej që lista e kandidatëve të ishte brenda dhomës ku votohej.

Edhe për arsye praktike (nisur nga numri i madh i kandidatëve të partive politike, psh në Bashkinë Tiranë numri i kandidatëve ishte 36 për secilën parti), mendojme se është e vështirë për qytetarët të mbajnë mend numrin që i korespondon kandidatit, për të cilin ata duan të votojnë.

Gjatë monitorimit tonë, konstatuam një rast, ku një qytetar, kërkoi leje dhe ndërpreu procesin e votimit, pasi doli jashtë për të parë listën me numrat e kandidatëve dhe u rikthye sërish për të plotësuar fletën e votimit.

3. Një çështje tjetër që mendojmë se meriton vëmendje, është edhe ajo e afishimit të listës së zgjedhësve.

Këto lista ishin afishuar në qendrat e votimit, të cilat duke qënë objekte shkollore, apo parashkollore, nuk kanë qënë të aksesueshme për publikun me përjashtim të ditës së votimit (kjo sepse, për shkak të masave anticovid, në këto ambiente nuk lejohej as hyrja e prindërve të fëmijëve që janë në këto institucione arsimore dhe jo më e personave të tjerë nga jashtë. Pra, listat mund të verifikoheshin vetëm ditën e votimit, për qytetarët.

Në shumicën e qendrave të votimit që monitoruam, na rezultoi se ato ishin afishuar në një distancë jo të përshtatshme për tu lexuar (ishin në lartësi dhe me gërma të vogla), c'ka e bënte të vështirë leximin e tyre (për të mos thënë të pamundur), jo vetëm nga personat e moshës së tretë, por edhe nga qytetarët e tjerë.

Në një rast konstatuam dy qytetarë që erdhën gabimisht tek një qendër votimi dhe ishte Komisioni i QV-së, ai që i orientoi dhe jo listat e afishuara.

Gjithashtu pavarësisht se formati i listës së votuesve të miratuar nga KQZ, parashikonte se në fund të çdo flete, duhej të firmosnin: nëpunësi i gjendjes civile dhe kryetarit i Bashkisë, si dhe të vulosej. Në mjaft raste listat e verifikuara nga ne, rezultuan të ishin vetëm me firmën e nëpunësit të gjendjes civile, (pra mungonte firma e kryetarit të Bashkisë, si dhe vula përkatëse).

- Për sa i perket masave anti Covid-19:

1. Nuk respektohej distancimi fizik midis votuesve që prisnin në radhë, jashtë QV-së, ndërsa brenda qendrës së votimit, herë respektohej dhe herë jo distancimi fizik.

Anëtarët e Komisioneve, duke qënë të zënë me votimin, nuk kishin mundësi reale të merreshin edhe me ruajtjen e distancimit.

Po kështu, në dijeninë tonë, nga institucionet përkatëse shtetërore, ditën e votimit, as nuk janë kryer inspektime dhe as nuk janë marrë masa të tjera (këshillime, gjoha) në qendrat e votimeve, apo pranë tyre. Korridoret e shkollave paraqisnin prani të shtuar të votuesve por edhe të personave të tretë, mbështetës eventuale të forcave politike garuese, të cilët qëndronin aty, megjithëse kishin përfunduar votimin.

2. Në kuadër të masave anti Covid-19, nuk ishte parashikuar matja e temperaturës së anetarëve të Komisioneve të Qendrave të Votimit, në mënyre periodike. Një gjë e tillë ishte aplikuar vetëm për Komisionet e QV-ve, që kanë operuar në IEVP (pra përpara hyrjes së tyre në IEVP, ju është matur temperatura).

Nga informacionet që kemi marrë nga media, është bërë publik vetëm një rast në qytetin e Fierit, ku një anëtar i Komisionit të Votimit, kishte rezultuar me shenja të Covid-19 (temperaturë e lartë) dhe ishte larguar nga Komisioni.

3. Në qendrat e votimit kishte dezinfektantë brenda ambjentëve të qendrave;
4. Ambientet e përbashkëta kishin ajrosje, ndërkohë që në mjaft raste ambientet brenda qendrave të votimit, nuk ishin plotësisht të ajrosura, për shkak të dritareve të cilat mbaheshin të mbyllura.
5. Anëtarët e Komisionit në mjaft raste nuk e mbanin maskën mbrojtëse.

## **2.2. Monitorimet në Institucionet e Edukimit të Veprave Penale, në ditën e votimit**

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimit të egër, Çnjerëzor ose Poshtëruar, si pjesë e strukturës së institucionit të Avokatit të Popullit, monitoroi procesin e votimit, në 9 institucione të ekzekutimit të vendimeve penale. Sipas planifikimit paraprak, tre grupe pune të institucionit të Avokatit të Popullit monitoruan procesin e votimit në datën 25.04.2021, në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) në: Durrës, Rrogozhinë, Peqin, Elbasan Fushë-Krujë dhe “Mine Peza”, “Ali Demi”, “Jordan Misja” në Tiranë. Ndërsa oficeri i kontaktit për çështjet e migracionit në Qarkun e Korçës, mori kontakt me Komisionerët e



Qendrës së Votimit në IEVP Korçë, si dhe monitoroi procesin e votimit të të paraburgosurve në këtë institucion.

- *Metodologjia e monitorimit në IEVP-të*

Grupet e punës kishin si qëllim monitorimin e procesit të votimit dhe vlerësimin e ushtrimit të së drejtës së votës nga ana e personave të privuar nga liria në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale. Në përputhje me procedurën e monitorimit, në secilin IEVP, u morën kontakte me drejtorët e institucioneve, juristët dhe personat e tjerë të ngarkuar nga institucioni për mbarëvajtjen e procesit të votimit, si dhe me kryetarët dhe sekretarët e qendrave të votimit. Gjithashtu, grupet e punës ndoqën nga afër procesin e votimit në qendrat e votimit nga ana e personave të privuar nga liria në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale. Monitorimi i këtij procesi kishte në fokus edhe zbatimin e Rekomandimeve të Avokatit të Popullit, të cilat janë bërë pas monitorimit të IEVP-ve në zgjedhjet e mëparëshme, lidhur me ushtrimin e të drejtës për të votuar nga ana e personave të privuar nga liria. Paraprakisht nga institucioni ynë i ishte kërkuar informacion nëpërmjet e-mail-it zyrtar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, lidhur me masat që janë marrë nga ky institucion për mbarëvajtjen e procesit të votimit si dhe mbi numrin e përgjithshëm të të burgosurve që do të votonin në të gjithë sistemin penitenciar<sup>18</sup>.

Në vijim të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve na ka vënë në dispozicion informacionin e kërkuar së bashku me numrin e të burgosurve që kishin të drejtën e votës dhe atyre që përjashtoheshin nga ligji nr. 135/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ose që nuk ishin të pajisur me mjete identifikimi.

Nga monitorimi i bërë në IEVP-të e cituara më sipër, rezultoi se:

- Drejtuesit e administratës të Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Komisionerët e Qendrave të Votimit ishin bashkëpunues dhe transparent ndaj punonjësve të institucionit tonë. Gjithashtu, ata demonstruan mirëkuptimin të plotë për misionin tonë dhe përmbushjen e qëllimit të monitorimit.

- Komisionet e qendrave të votimit ishin me anëtarë, të cilët u përkisnin subjekteve përkatëse zgjedhore dhe jashtë institucioneve të monitoruara. Në qendrat e votimit kishte vëzhgues vendas, ndërsa në disa prej tyre edhe vëzhgues të huaj. Në IEVP Elbasan, grupi ynë i inspektimit vëzhgoi procesin edhe me prezencën e vëzhguesve të huaj, nga Zyra e Bashkimit Evropian, në Tiranë.

- Ambientet e votimit në këto qendra votimi ishin me kushte normale dhe të pajisuara me bazën e nevojshme materiale, për realizimin e procesit të votimit.

<sup>18</sup> Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut, neni 21.3; Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 25 (b); Protokollin nr. 1 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ), neni 3.

Procedurat e votimit nga komisioni i qendrave të votimit dhe votimi i personave të privuar nga liria ishin konform Kodit Zgjedhor. Kështu në përputhje me parashikimet ligjore u bënë verifikimet e votuesve mbi bazën e dokumentave të identitetit, bazuar në të dhënat në listat e zgjedhësve apo vendimevetëe gjykatave, nënshkrimi i tyre në lista, vendosja e shënjes në gisht pas votimit, si dhe sigurimi i fshehtësisë së votës. Votimi u krye në dhomat e votimit, numri i të cilave ishte i ndryshëm, një deri në dy të tilla, në IEVP të ndryshme. U konstatua se votimi ishte i qetë dhe nuk kishte probleme ndërmjet komisionerëve.

- Numri i votuesve (të dënuar dhe të paraburgosur) në këto institucione, sipas listave të zgjedhësve, ishte 2628 persona, të dënuar dhe të paraburgosur.

- Sipas punonjësve të administratës së IEVP-ve, listat e zgjedhësve ishin sjellë në këto institucione nga bashkitë përkatëse, në juridiksionin e të cilave ato bënë pjesë, në afatin e parashikuar nga Kodi Zgjedhor dhe ishin afishuar në vende të aksesueshme nga të dënuarit dhe të paraburgosurit, vende të tilla si hyrje - daljet e ambienteve të ajrimit dhe tek njësitë tregtare.

- Pas ardhjes dhe afishimit të listave të zgjedhësve në këto institucione, për personat të cilët nuk gjendeshin në këto lista, nga punonjësit e sektorit juridik ishte organizuar puna në bashkëpunim me të dënuarit dhe paraburgosurit, duke ju drejtuar Gjykatave të Rretheve Gjyqësore përkatëse, me kërkesa për ushtrimin e së drejtës së votës.

- Nga të dhënat e marra në qendrat e votimit dhe administrata e institucioneve të monitoruara nga institucioni ynë rezultoi se, organeve gjyqësore i janë drejtuar me kërkesë për të marrë pjesë në zgjedhje, 117 persona, të dënuar dhe të paraburgosur. Deri në momentin e inspektimit nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore ishin pranuar kërkesat e 113 personave të dënuar dhe të paraburgosur, duke i dhënë atyre të drejtën për të votuar. Ndërsa për pjesën e mbetur priteshin vendimet e gjykatave respektive.

- Një numër i konsiderueshëm i të dënuarëve që ndodheshin në këto institucione ishin përjashtuar nga e drejta e votimit sipas ligjit për dekriminalizimin. Nga verifikimet e bëra me disa prej të dënuarëve, të cilët megjithëse u paraqitën në qendrat e votimit nuk mundën të votonin sepse nuk ishin në listat e zgjedhësve, rezultoi se përjashtimi i tyre ishte korrekt dhe në përputhje me ligjin, pasi ishin dënuar për veprat penale të parashikuara në ligjin përkatës.

Nga monitorimi u konstatua se disa votues, të cilët ishin në listën e zgjedhësve apo kishin vendime gjyqësore për të votuar nuk mundën të votonin, sepse nuk kishin dokumente identifikimi. Nga verifikimet e kryera rezultoi se mungesa e dokumentacionit të identifikimit kishte ardhur për shkaqe të ndryshme. Ndër këto shkaqe mund të përmendim, faktin se disa prej tyre i kishin humbur ato, disa të paraburgosur i kishin në dosjet penale të cilat ishin në hetim në organin e prokurorisë, disa prej tyre i kishin në shtëpi, etj. Mungesa e dokumentacionit kishte ardhur, si për shkak të mosinteresimit të vetë votuesve, ashtu edhe të familjarëve të

tyre por edhe nga pamundësia financiare, megjithëse ishin njoftuar disa muaj më parë nga administrata e IEVP-ve.

Gjithashtu u konstatuan edhe raste ku disa persona, ndonëse të pakët, nuk ishin të regjistruar në listën e zgjedhësve dhe nuk kishin as vendim gjyqësor për të ushtruar këtë të drejtë. Nga verifikimet e bëra rezultoi se ata nuk kishin treguar interes për këtë problem, ose ishin të paraburgosur që kishin ardhur në këto institucione ditët e fundit para ditës së votimit mbi bazën e vendimeve gjyqësore për caktimin e masës së sigurisë “arrest në burg”. Ndërkohë disa prej tyre ishin liruar ditët e fundit, disa ishin shtruar në IVSHB Tiranë, për shkak të problemeve shëndetësore, etj.

Në vijim të Urdhrit nr. 1783, datë 13.02.2021, “*Për pajisjen e të gjithë të burgosurve me dokument identifikimi*”, të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, i cili parashikon ndër të tjera vënien në dijeni të të burgosurve mbi mungesën e mjetit të identifikimit si dhe u parashikimin e mundësisë për kryerjen e aplikimit për pajisjen me të u konstatuan edhe raste ku disa persona, ndonëse ndodheshin në listën e zgjedhësve, në vijim edhe të njoftimit nga institucioni për mungesën e tij kishin deklaruar se nuk donin të pajiseshin me mjetin e identifikimit, duke refuzuar me vullnetin e tyre të lirë të merrnin pjesë në këtë proces zgjedhor.

Nga grupet e punës u zhvilluan edhe intervista konfidenciale me disa të dënuar dhe të paraburgosur lidhur me procesin e votimit dhe ushtrimin e lirë të së drejtës së votës. Nga intervistimi i tyre rezultoi se ndaj tyre nuk ishte ushtruar presion apo ndikim nga administrata e IEVP-ve, lidhur me votimin për subjekte të caktuara zgjedhore.

### **3. Çështje të tjera:**

#### *3.1. Moskrijimi i qendrave të votimit në spitale.*

Udhëzimi nr 1, datë 05.12.2020, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve/Komisioni Rregullator, në nenin 3, pika 2 parashikon se: «*Qendrat e votimit krijohen ....c. në institucione të posaçme ku përfshihen: burgjet, vendet e paraburgimit, si dhe spitalet ose institucionet e tjera shëndetësore, që pranojnë pacientë për më shumë se 3 ditë*».

Nga verifikimi ynë rezultoi se në asnjë institucion shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, që pranon pacientë për më shumë se 3 ditë, nuk janë ngritur qendra votimi.

Nisur nga situata e shkaktuar nga epidemia e virusit COVID-19, ku pacientët me këtë lloj virusi duhet të izoloohen/karantinohen, apo edhe për pacientë të tjerë, të cilët e kanë pasur të pamundur të linin ambjentet spitalore dhe të shkonin për të ushtruar

të drejtën e votës, mendojmë se konform parashikimeve të Udhëzimit të sipërcituar, mund të ishin ngritur qendra votimi, veçanërisht në ato institucione shëndetësore, ku kishte numër të madh pacientësh.

### 3.2. *Numri i fletëve të votimit të pavlefshme*

Sipas informacioneve të publikuara në faqen zyrtare të KQZ-së, numri i votave të pavlefshme në këto zgjedhje, ishte 83.000, ç'ka përbën një numër të lartë, por edhe një përqindje të rritur, të votave të pavlefshme, në krahasim me zgjedhjet e mëparshme.

Nisur nga sa më sipër, do rekomandonim që pavarësisht punës së bërë për informimin e publikut mbi mënyrën e votimit, do të duhet të studiohet e përmirësohet, e gjithë procedura e mënyrës së votimit (duke filluar nga formati i fletës së votimit dhe deri tek spotet televizive, me qëllim që të ulet numri i votave të pavlefshme).

Po kështu, edhe për sa i përket pretendimeve të ngritura në media nga parti apo kandidatë të ndryshëm, për bërje votash të pavlefshme nga numëruesit, do të rekomandonim që të merreshin masa konkrete, për parandalimin e kësaj mundësie.

## **4. Rekomandime:**

Në kuadër të çështjeve të përmendura në këtë Raport, bazuar në angazhimin konkret dhe trajtimin analitik të çështjeve dhe problematikave të caktuara, të konstatuara nga ana e Avokatit të Popullit për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të mbajtura në 25 prill 2021, paraqiten këto rekomandime:

### 1. Për zbatimin në mënyrë korrekte të akteve normative në fuqi:

- Të garantohet plotësisht dhe atje ku kjo gjë nuk është e mundur, sipas një standardi minimum detyrues, nga ana e organeve përgjegjëse të vetëqeverisjes vendore dhe Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, krijimi i lehtësive për votimin e personave me aftësi të kufizuara, në qendrat e votimit.
- Garantimi i së drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuara, duke filluar nga përshtatshmëria infrastrukturore në hyrje të godinave të qendrave të votimit, duke:
  - a) vendosur në çdo godinë rampa për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë.
  - b) vendosur sinjalistikën me shirita të verdhë për personat me aftësi të kufizuara në shikim.

- Marrjen e masave lidhur me garantimin e fshehtësisë së votës, veçanërisht për votuesit e moshës së tretë dhe me aftësi të kufizuara, kur votimi kryhet në mënyrë elektronike.
- Marrjen e masave për ndërgjegjësimin e votuesve (moshës së tretë, personave me aftësi të kufizuara, etj), mbi mënyrën e realizimit të votimit elektronik.
- Marrjen e masave për identifikimin e personave me aftësi të kufizuara në lëvizje dhe vendosjen për të votuar vetëm në qendrat e votimit që ndodhen në katet e para të godinave, në mënyrë që tu garantohet e drejta për të votuar.
- Marrjen e masave të nevojshme nga ana e Bashkive, për dërgimin në afatin ligjor të parashikuar nga Kodi Zgjedhor, të listave të zgjedhësve në IEVP-të, të cilat janë në juridiksionin tokësor të tyre.
- Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen me dokumentin e identifikimit të të burgosurve, që në momentin e pranimit në ambientet e IEVP-ve. Kjo gjë duhet të konsiderohet si një detyrim ligjor<sup>19</sup> dhe si një nevojë për zhvillimin e procesit të rregullt zgjedhor dhe ushtrimin e së drejtës së votës.
- Marrjen e masave për gjetjen e zgjidhjeve ligjore, për pajisjen e të burgosurve me mjete identifikimi alternative kur është e qartë pamundësia e tyre financiare për këtë qëllim.
- Marrjen e masave të nevojshme nga ana e Drejtorive të IEVP-ve, për ti kërkuar bashkive respektive dërgimin në kohë të listave të zgjedhësve, për personat e privuar nga liria, të dënuar dhe paraburgosur.
- Drejtoritë e IEVP-ve duhet të marrin masat e nevojshme për të njoftuar disa muaj para ditës së votimit dhe për të sensibilizuar personat e privuar nga liria, për mundësimin e pajisjes së tyre në kohë, me dokumenta identifikimi (disponimin e tyre kur i kanë, apo bërjen e dokumentave të rinj të identifikimit në rastet kur u mungojnë), me qëllim realizimin e të drejtës themelore për të zgjedhur.

## 2. Rekomandime legjislative:

- Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve të përmirësojë në një kohë të shpejtë, në vazhdim, bazën ligjore, që lidhet me parashikimet detyruese, ndaj organeve shtetërore përgjegjëse për krijimin e lehtësive për votimin e personave me aftësi të kufizuar në qendrat e votimit.

<sup>19</sup> Bazuar në ligjin nr. 81/2020, në nenin 88, pika 1, gërma “dh” ku parashikohet “1. Pranimi i të paraburgosurve kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 38 të këtij ligji dhe shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm: dh) **certifikatën personale dhe dokumentin e identifikimit** dhe në mungesë të tyre, dokument identifikimi të përgatitur nga Policia e Shtetit.”

- Rekomandohet plotësimi i legjislacionit që garanton votën e emigrantëve.
- Vendimmarrja e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për marrjen e masave parandaluese ndaj infeksionit të përhapjes së Covid 19, si dhe veprimtaria e strukturave të tjera profesionale këshilluese, të krijuara për këtë qëllim, duhet të përfshijë në spektrin konsultues paraprak, mendimet dhe qëndrimet e institucioneve shtetërore, të specializuara, për problematika që janë sensitive dhe që prekin, apo sjellin pasoja të drejtëpërdrejta, për të drejtat themelore të njeriut.

Në përfundim të gjithë sa më sipër, Avokati i Popullit si një institucion i pavarur Kushtetues, që ka si shtylla kryesore të veprimtarisë së tij, mbrojtjen, parandalimin e shkeljeve dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të ligjshme të individëve, të cilat i sheh të lidhura ngushtë edhe me mirëfunksionimin dhe mirëadministrimin e proceseve zgjedhore, siguron se këto procese do të vazhdojnë të jenë një nga prioritetet e veprimtarisë së punës së institucionit tonë.

**AVOKATI I POPULLIT**

**Erinda BALLANCA**



## 9. ANEKSE